



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA FIER  
DREJTORIA E MBROJTJES CIVILE

Nr. 11039/1 prot.

Fier, më 06.11.2024.

**LËNDA:** Relacion për hartimin dhe miratimin e dokumentit "Strategjia Vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit", në territorin e Bashkisë Fier.

**Qëllimi :** Hartimi i dokumentit "Strategjia Vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit", në territorin e Bashkisë Fier, sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile".

1. Bashkia Fier me qëllim hartimin e dokumentit "**Strategjia Vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit**" sipas kërkesave të ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile", nxori Urdhrin nr.18, datë 17.01.2024, për krijimin dhe funksionimin e Grupit Teknik të Punës në Bashki për hartimin e "**Strategjisë Vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Planit Vendor për Emergjencat Civile**", me grupin teknik të punës që ngarkohej që të punonte për hartimin e këtij dokumenti.
2. Në hartimin e këtij dokumenti, Grupi Teknik në nivel Bashkie për procesin e hartimit të Dokumenteve Strategjike për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë, në koordinim me Agjencinë Kombëtare të Mbrojtjes Civile u mbështet nga kompania konsulente në kuadër të projektit RESEAL të UNDP.
3. Gjatë periudhës së punës së këtij Grupi Teknik:
  - U grumbullua gjithë informacioni i nevojshëm mbi risqet e mundshme nga përmbytjet, tërmetet, zjarret në pyje, rrëshqitjet e tokës, ndotjet teknologjike dhe aksidentet industriale dhe risqet biologjike që mund të jenë prezentë në territorin e Bashkisë Fier.
  - U bë studim i gjithë zonave me risk të shtuar të fatkeqësive duke pyetur komunitetin e zonave të banimit, bizneset dhe grupet e interesit.
  - U zhvilluan takime me persona kyç dhe u plotësuan pyetësorë për të marrë të dhënat referencë për hartimin e strategjisë.
  - Grupi i punës, i mbështetur nga kompania konsulente, hartoi dokumentin e strategjisë bazuar në të dhënat e mbledhura dhe konsultimet e kryera.
4. Gjatë periudhës së punës së këtij Grupi Teknik u bënë disa dëgjesa publike, veçanërisht për konsultimin e planit të veprimit të strategjisë me qëllim rregullimin e pasaktësive të mundshme dhe finalizimin e dokumentit. Në këto dëgjesa u ftuan të merrnin pjesë komuniteti lokal, bizneset dhe grupet e interesit, duke siguruar një përfshirje të plotë dhe të gjithanshme.

5. Dëgjesat publike dhe takimet me komunitetin lokal, bizneset dhe grupet e interesit ndihmuan në diskutimin dhe përmirësimin e draftit të Strategjisë Vendore për ZRF. Këto konsultime siguruan identifikimin e sfidave kryesore dhe përfshirjen aktive të të gjithë aktorëve të rëndësishëm në procesin e hartimit të strategjisë.
6. Për të siguruar një qasje të koordinuar në nivel rajonal, u organizuan takime ndërmjet kryetarëve të bashkive të Qarkut Fier dhe Prefektit. Synimi ishte integrimi i Zvogëlimit të Riskut nga Fatkeqësitë në politikat dhe planet rajonale, duke siguruar harmonizimin e strategjisë vendore me objektivat më të gjera të qarkut.
7. Me përfundimin e dëgjesës së fundit të zhvilluar në datën 10.10.2014 u mbyll cikli i dëgjesave dhe Grupi Teknik finalizoi dokumenti në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 45/2019 datë 18.07.2019 "Për Mbrojtjen Civile". Dokumenti reflekton kontributet e marra gjatë procesit të konsultimit dhe synon të përmirësojë aftësinë e bashkisë për të menaxhuar dhe zvogëluar risqet nga fatkeqësitë.
8. Dokumenti do të shërbejë si një udhërrëfyes kyç për Planifikimin e Zhvillimit Urban, duke integruar masat për ZRF. Ky integrim do të sigurojë që planifikimi urban dhe zhvillimi i bashkisë të marrë në konsideratë rreziqet natyrore dhe mjedisore, duke mbrojtur komunitetin dhe duke rritur qëndrueshmërinë e tij.
9. Ky dokument është themelor për përmirësimin e aftësisë së bashkisë për të menaxhuar risqet nga fatkeqësitë, por në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 45/2019, ai duhet të rishikohet dhe përmirësohet vazhdimisht, për t'u përshtatur me ndryshimet e mundshme në sfidat dhe rreziqet që mund të shfaqen.
10. Grupi Teknik vlerëson se dokumenti "**Strategjia Vendore për zvogëlimin e riskut nga fatkeqësitë dhe Plani i Veprimit**", është i përfunduar dhe përfaqëson një dokument cilësor që i paraqitet kësaj bashkie, ndaj mendojmë dhe kërkojmë miratimin e tij nga Këshilli i Bashkisë Fier.

**Ju faleminderit!**

**DREJTORI I MBROJTJES CIVILE**

Nasip Bani

